ÇFARË NDODH PAS DIPLOMIMIT NGA SHKOLLA? REZULTATET NGA GJURMIMI I TË DIPLOMUARVE 2016-2025

Shkolla Industriale Pavarësia

© 2026 Swisscontact

Rreth projektit "Aftësi për Punë" S4J

"Aftësi për Punë" S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact. S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Lista e tabelave

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit (2016-2025) 9
Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2025) 15
Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2016-2025) 15
Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2016-2025) 16
Tabela 5: Perceptimet për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2016-2025) 22
Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2016-2025) 23
Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2016-2025) 24
Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2016-2025) 24
Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2025) 27
Tabela 10: Arsyet kryesore të papunësisë (2016-2025) 29
Tabela 11: Arsyet kryesore të mos kërkimit për punë (2020-2025) 29
Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkollë “shumë/jashtëzakonisht shumë” (2016-2025) 30
Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2018-2025) 32
Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2016-2025) 32

Lista e figurave

Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2025) 9
Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2025) 10
Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2025) 10
Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2025) 11
Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2016-2025) 11
Figura 6: Punësimi përkundrejt vetë-punësimit (2016-2025) 12
Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2025) 13
Figura 8: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2016-2025) 13
Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2016-2025) 14
Figura 10: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2025 16
Figura 11: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) (2016-2025) 18
Figura 12: Niveli i pagave sipas drejtimit (2025) 18
Figura 13: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt punësimit me kohë të pjesshme (2016-2025) 19
Figura 14: Madhësia e kompanisë (2016-2025) 20
Figura 15: Lloji i kontratës (2016-2025) 20
Figura 16: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2016-2025) 21
Figura 17: Periudha kohore në kërkim të një pune (2025) 22
Figura 18: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2025) 25
Figura 19: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2025) 25
Figura 20: Lloji i institucionit (2020-2025) 26
Figura 21: Lidhja e studimeve me profesionin (2020-2025) 27

Figura 22: Papunësia ndër vite (2016-2025) 28
Figura 23: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2025) 28
Figura 24: Niveli i të diplomuarve të papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2016-2025) 30
Figura 25: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2016-2025) 31

Tabela e përmbajtjes

Lista e tabelave 3
Lista e figurave 3
Gjetjet kryesore 6
Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve? 7
Të diplomuarit 2016-2025 9
Analiza e rezultateve 11
Statusi i punësimit 11
Lidhja e punës me fushën e arsimit 13
Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës 15
Niveli i pagave 16
Kushtet e punës 19
Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqësia në vendin e punës 22
Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë 22
Mënyrat e gjetjes së punës së parë 23
Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme 25
Të diplomuarit pa punë 28
Propozimet për përmirësim në shkollë 30
Planet për të ardhmen 32

Gjetjet kryesore

Ky raport paraqet rezultatet kryesore nga gjurmimi i dhjetë brezave të të diplomuarve të Shkollës Industriale Pavarësia, nga viti 2016 deri në vitin 2025.


- Në vitin 2025, 77% e të diplomuarve të gjurmuar ishin të punësuar/vetëpunësuar një vit pas diplomimit, përfshirë ata që punonin dhe studionin në të njëjtën kohë. Kjo përqindje është 9 pikë përqindjeje mbi mesataren e viteve 2016–2024 (68%).
- Në vitin 2025, 12% e të diplomuarve të gjurmuar ishin të papunë një vit pas diplomimit. Nga të diplomuarit e papunë, 78% ishin në kërkim të një pune, ndërsa 22% nuk kërkonin punë.
- Sipas drejtimeve, në vitin 2025 ishin të punësuar/vetëpunësuar një vit pas diplomimit 100% e të diplomuarve në Termohidraulikë, 89% në Mekanikë, 77% në SHMT, 73% në TIK dhe 69% në Elektroteknikë.
- Në vitin 2025, 35% e të diplomuarve të pyetur u shprehën se puna aktuale lidhet me fushën e tyre të arsimit, niveli më i ulët i raportuar ndër vite. Ndërkohë, sipas analizës së raportit, 46% pohojnë se i përdorin njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë studimeve në vendin e punës “shumë/jashtëzakonisht shumë”, kundrejt mesatares 2016–2024 prej 41%.
- Për vitin 2025 shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 23% deri në 50,000 lekë, 20% në fashën 50,001–60,000 lekë, 14% në fashën 60,001–80,000 lekë, 11% në fashën 80,001–95,000 lekë, 9% në fashën 95,001–120,000 lekë dhe 23% mbi 120,000 lekë.
- Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve, paga mbi 80,000 lekë marrin 50% e të diplomuarve në Termohidraulikë, 43% në Elektroteknikë, 35% në TIK dhe 25% në secilin prej drejtimeve Mekanikë dhe SHMT. Ndërkohë, paga 60,001–80,000 lekë marrin 30% e të diplomuarve në TIK, 25% në Mekanikë dhe 13% në SHMT.
- 66% e të diplomuarve e kanë gjetur punën e parë para diplomimit. Njohjet, lidhjet familjare dhe miqtë mbeten mënyra kryesore e gjetjes së punës së parë (55%), ndërsa 23% e kanë gjetur atë përmes njoftimeve në faqe interneti, media sociale apo gazetë.
- 73% e të diplomuarve të pyetur ndjehen “të sigurt ose shumë të sigurt” në punën aktuale, rreth 8 pikë përqindjeje mbi mesataren e viteve 2016–2024 (65%). Ndërkohë, 9% ndjehen “shumë të pasigurt”, kundrejt mesatares prej rreth 6%. Gjithashtu, 73% shprehen “të kënaqur ose shumë të kënaqur” me punën aktuale, ndërsa 5% “shumë të pakënaqur”.
- Nevojat më të theksuara për përmirësimin e shkollës në vitin 2025 lidhen me këshillimin e karrierës (67%), praktikën në shkollë (64%), aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve (63%), bashkëpunimin me bizneset (63%) dhe praktikën në biznes (61%). Këto përqindje pasqyrojnë të diplomuarit që vlerësojnë se këto aspekte kanë “shumë/jashtëzakonisht shumë” nevojë për përmirësim.
- Për dy vitet e ardhshme, 52% e të diplomuarve në vitin 2025 dëshirojnë të kenë filluar biznesin e tyre, niveli më i lartë ndër vite, kundrejt mesatares 2016–2024 prej rreth 30%. Ndërkohë, 25% dëshirojnë të jenë të punësuar dhe 27% të kenë gjetur një punë që lidhet me fushën e tyre të studimit.

Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e një institucioni arsimor realizohet përmes 'studimeve gjurmuese' që ndjekin ose 'gjurmojnë' **të diplomuarit** pasi ata diplomohen. Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të arsimit profesional në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.

Të dhënat dhe rezultatet e gjurmimit përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi **relevancën e ofertës** për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura. Tematikat e gjurmimit janë të shumëfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve.

Avantazhet e një sistemi gjurmimi në nivel ofruesi



Në këtë kuadër, Shkolla Industriale Pavarësia, me mbështetjen e projektit 'Aftësi për Punë' (S4J) ka ngritur një **sistem gjurmimi** në nivel ofruesi për të diplomuarit e saj. Ky sistem gjurmimi përmbush dy qëllime të rëndësishme:

a. Monitorimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e shkollës.
b. Vlerësimin e lidhjes (përputhshmërisë horizontale) midis arsimit dhe punës.

Zbatimi i procesit të gjurmimit në praktikë zhvillohet në **tre faza kryesore** siç është e ilustruar në diagramën më poshtë.



Në fazën e para-gjurmimit, që kryhet në majin e çdo viti shkollor, realizohet para-gjurmimi i maturantëve që pritet të diplomohen në qershor. Para-gjurmimi kryhet me anë të një pyetësori të strukturuar online. Anketa mbledh të dhënat e kontaktit të maturantëve, karakteristikat e tyre socio-demografike, si dhe planet dhe pritshmëritë e tyre të karrierës për të mundësuar kështu gjurmimin e tyre një vit më pas.

Në fazën e gjurmimit, që kryhet në qershorin e çdo viti shkollor realizohet gjurmimi i të diplomuarve nga shkolla një vit më parë. Të diplomuarit raportojnë mbi përvojën e kalimit në tregun e punës dhe bëjnë vlerësimin në retrospektivë të shkollës së tyre përmes një pyetësori të standardizuar online duke përdorur platformën Kobo Toolbox.

Në fazën përmbyllëse të procesit analizohen rezultatet e gjurmimit dhe prezantohen rezultatet. Pjesa më e rëndësishme e procesit është leximi i këtyre gjetjeve dhe reflektimi i brendshëm i institucionit mbi të dhënat dhe ndërmarrja e hapave konkrete si rrjedhojë.

Procesi i gjurmimit koordinohet nga **koordinatori i gjurmimit** me mbështetjen e Njësisë së Zhvillimit dhe mësuesve kujdestarë, nën kujdesin e projektit ‘Aftësi për Punë’.

Ky raport përmbledhës pasqyron rezultatet kryesore nga gjurmimi i **dhjetë brezave me të diplomuar** të Shkollës Industriale Pavarësia.

Të diplomuarit 2016-2025


Në vitin shkollor 2024-2025, në Shkollën Industriale Pavarësia u diplomuan 85 nxënës (shiko tabelën 1), 13 nxënës më pak sesa gjatë vitit 2023-2024.

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit (2016-2025)

Brezi	Të diplomuar	Të anketuar	%
2015-2016	73	20	27%
2016-2017	98	59	60%
2017-2018	126	61	48%
2018-2019	95	55	58%
2019-2020	124	103	83%
2020-2021	149	121	81%
2021-2022	125	101	81%
2022-2023	93	79	85%
2023-2024	98	77	79%
2024-2025	**85**	**73**	**86%**

Nga të diplomuarit e vitit 2024-2025 u gjurmuan 73 nxënës ose 96% e të diplomuarve. 93% (N=68) e të diplomuarve të gjurmuar i përkasin gjinisë mashkullore dhe vetëm 7% (N=5) i përket gjinisë femërore (shiko figurën 1).


Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=73

Ndërsa të shpërndarë sipas drejtimeve (shiko figurën 2), përqindjen më të lartë të të gjurmuarve e kanë të diplomuarit e drejtimit TIK me 45% dhe më të voglin ata të drejtimit Termohidraulikë me 7%.


Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=73

Të pyetur lidhur me vendbanimin, 92% e të diplomuarve janë përgjigjur se jetojnë në Shqipëri. Mesatarisht, gjatë viteve 2020-2025, 91% e të diplomuarve të gjurmuar jetojnë në Shqipëri dhe 9% jetojnë jashtë vendit.

Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2020** (N=103); **2021** (N=121): **2022** (N=101); **2023** (N=79), **2024** (N=77), **2025** (N=73)

Analiza e rezultateve

Statusi i punësimit

Sipas rezultateve të brezit të fundit të të gjurmuarve (2022-2025), nga një total prej 73 të anketuarish 49% ishin të punësuar një vit pas diplomimit (shiko figurë 3), 17% ishin të vetëpunësuar, 11% ishin student/kursant, 11% ishin të punësuar por edhe studionin në të njëjtën kohë. Ndërkohë, të papunë ishin 12% e të diplomuarve.


Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=73

Në vitin 2025, 77% e të diplomuarve ishin të punësuar/vetëpunësuar një vit pas diplomimit (shiko figurën 5), me një rritje prej 9 pikësh përqindje nga mesatarja 2016-2024 (68%). Ndërkohë, 12% e të diplomuarve janë të papunë një vit pas diplomimit, me një ulje prej 8 pikësh përqindje nga mesatarja 2016-2024 (20%). Studime të mëtejshme ndjekin 11% e të diplomuarve, me të njëjtën përqindje sa mesatarja 2016-2024 (11%).


Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=20); **2017** (N=58); **2018** (N=61); **2019** (N=55); **2020** (N=103); **2021** (N=121); **2022** (N=101); **2023** (N=79), **2024** (N=77), **2025** (N=73)

Të anketuarit që janë shprehur se janë në marrëdhënie pune janë pyetur më tej nëse janë të punësuar apo të vetë-punësuar. Sikurse vihet re nga figura 6, shumica e të diplomuarve ndër vite janë shprehur se janë të punësuar dhe një numër i vogël prej tyre janë të vetë-punësuar. E shprehur në përqindje mesatarisht 10% të diplomuar vetë-punësohen në vit ndërsa 51% punësohen.


Figura 6: Punësimi përkundrejt vetë-punësimit (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=20); **2017** (N=58); **2018** (N=61); **2019** (N=55); **2020** (N=103); **2021** (N=121); **2022** (N=101); **2023** (N=79), **2024** (N=77), **2025** (N=73)

Në figurën 7, jepet statusi i punësimit sipas drejtimeve të ofruara nga shkolla. Sikurse vihet re, 100% e të diplomuarve në Termohidraulikë, 89% e të diplomuarve në Mekanikë, 77% e të diplomuarve në SHMT dhe 73% e të diplomuarve në TIK dhe 69 e të diplomuarve në Elektroteknikë janë të punësuar/vetëpunësuar një vit pas diplomimit. Ndërkohë, 15% e të diplomuarve në TIK dhe 15% në Elektroteknikë janë student/kursant. Ndërkohë, nivelin më të lartë të papunësisë e kanë të diplomuarit në Elektroteknika me 15%, SHMT po 15%, TIK 12% si dhe Mekanikë 11%.

Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: EL** (N=13); **TH** (N=5); **M** (N=9); **SHMT** (N=13); **TIK** (N=33).

Lidhja e punës me fushën e arsimit

Të pyetur nëse puna aktuale lidhet me fushën e tyre të arsimit, 35% e të diplomuarve u përgjigjën pozitivisht. Kjo shënon dhe përqindjen më të ulët ndër vite e të diplomuarve pohojnë se puna lidhet me fushën e tyre të arsimit. Ndër vite (shiko figurën 8), më shumë se gjysma e të diplomuarve (54%) pohojnë se puna lidhet me fushën e tyre të studimit.


Figura 8: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=9); **2017** (N=37); **2018** (N=36); **2019** (N=33); **2020** (N=74); **2021** (N=92); **2022** (N=81); **2023** (N=49), **2024** (N=58), **2025** (N=44)

Nëse analizojmë lidhjen e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (shiko figurën 9), vërehet se mesatarisht 57% e të diplomuarve në Termohidraulikë, 63% e të diplomuarve në Mekanikë, 52% e të diplomuarve në SHMT dhe 58% e të diplomuarve në profilin Elektroteknikë pohojnë se punojnë në profesionin e tyre. Ndërkohë, mesatarisht 40% e të diplomuarve në drejtimin TIK pohojnë se punojnë në profesionin e tyre. Përgjithësisht në çdo drejtim vihet re një rënie e përqindjes vit pas viti.

Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2020**: N_{TIK}=15, N_{SHMT}=26, N_{M}=13, N_{TH}=11, N_{EL}=9; **Baza 2021**: N_{TIK} =25, N_{SHMT} =21, N_{M} =33, N_{TH} =5, N_{EL} =8;

Baza 2022: N_{TIK}=22, N_{SHMT}=15, N_{M}=15, N_{TH}=13, N_{EL}=16; **Baza 2023:** N_{TIK}=5, N_{SHMT}=11, N_{M}=14, N_{TH}=6, N_{EL}=4 ; **Baza 2024:** N_{TIK}=16, N_{SHMT}=9, N_{M}=10, N_{TH}=9, N_{EL}=4, ; **Baza 2025:** N_{TIK}=24, N_{SHMT}=9, N_{M}=5, N_{TH}=2, N_{EL}=8

Të pyetur lidhur me arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (shiko tabelën 2), të diplomuarit e brezit 2025 përmendin tre arsye kryesore: (i) pamundësinë për të gjetur një vend pune që lidhet me studimet (37%, nga 45% në 2024), (ii) mungesën e dëshirës për të punuar në një punë që lidhet me studimet (27%, nga 14%) dhe (iii) pagën apo kushtet më të mira që ofron puna aktuale (17%, nga 27%). Krahasuar me brezin e mëparshëm, është rritur pesha e preferencës për të punuar jashtë fushës së studimeve, ndërsa është ulur pesha e dy arsyeve të tjera.

Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2025)

	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Nuk gjeta një vend pune që lidhet me studimet e mia	43%	80%	31%	35%	50%	45%	45%	**37%**
Nuk dua të punoj në një punë që lidhet me studimet e mia	21%	10%	0%	3%	6%	14%	14%	**27%**
Nuk ka oferta pune në fushën time në rajon	7%	0%	34%	16%	6%	5%	5%	**7%**
Puna që kam më ofron pagë/kushte më të mira	7%	0%	34%	42%	35%	27%	27%	**17%**
Tjetër	21%	10%	0%	3%	3%	9%	9%	**13%**

Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës

Të pyetur nëse njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë studimit i përdorin në vendin e punës (shiko tabelën 3), rezultatet e gjurmimit të të diplomuarve në 2025 tregojnë se njohuritë përdoren "shumë/jashtëzakonisht shumë" nga 46% e të gjurmuarve, me një rritje prej 5 pikësh përqindje nga mesatarja 2016-2024 (41%). Ndërkohë, 23% e të diplomuarve i përdorin aspak njohuritë e fituara gjatë studimeve në vendin e punës me një përmirësim prej 5 pikësh përqindje nga mesatarja 2016-2024 (28%). Në vitin 2025, 21% e të diplomuarve të gjurmuar pohojnë se i përdorin disi njohuritë e fituara gjatë studimeve me një ndryshim prej 1 pikë përqindje nga mesatarja 2016-2024 (20%).

Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2016-2025)

	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
2016	33%	11%	22%	0%	33%
2017	44%	2%	12%	9%	33%
2018	28%	17%	14%	25%	17%
2019	37%	13%	13%	16%	21%
2020	42%	8%	30%	15%	5%
2021	11%	10%	18%	20%	41%
2022	23%	21%	17%	14%	25%
2023	19%	10%	25%	19%	27%

2024	19%	9%	26%	19%	28%
2025	**23%**	**9%**	**21%**	**29%**	**18%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=9); **2017 (**N=43); **2018 (**N=36) **2019** (N=38); **2020** (N=74), **2021** (N=92); **2022** (N=81); **2023** (N=59); **2024** (N=58), **2025** (N=56)

Të pyetur për lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve të kryera (shiko tabelën 4), 36% e të diplomuarve në vitin 2025 e vlerësojnë lidhjen e pozicionit të punës me studimet e kryera me "shumë/jashtëzakonisht shumë". Mesatarisht, 2016-2024, 41% e të diplomuarve e kanë vlerësuar lidhjen e pozicionit të punës me studimet e kryera me "shumë/jashtëzakonisht shumë". Nga ana tjetër, 37% e vlerësojnë me "pak/aspak" lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimit.

Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2016-2025)


	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
2016	33%	11%	11%	33%	11%
2017	44%	12%	7%	5%	33%
2018	33%	14%	17%	11%	25%
2019	39%	8%	18%	18%	16%
2020	42%	7%	30%	18%	4%
2021	15%	3%	21%	37%	24%
2022	20%	25%	20%	16%	20%
2023	20%	8%	23%	28%	20%
2024	21%	9%	24%	26%	21%
2025	**30%**	**7%**	**27%**	**23%**	**13%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=9); **2017 (**N=43); **2018 (**N=36) **2019** (N=38); **2020** (N=74), **2021** (N=92); **2022** (N=81); **2023** (N=60) **2024** (N=58), **2025** (N=56)

Niveli i pagave

Përsa i përket nivelit të pagave për të diplomuarit e punësuar, një vit pas diplomimit, për vitin 2025 (shiko figurën 10), shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 23% më pak se paga minimale deri në 50,000 lekë, 20% në fashën 50,001-60,000 lekë, 14% në fashën 60,001-80,000 lekë, 11% në fashën 80,001-95,000 lekë, 9% në fashën 95,001 -120,000 lekë dhe 23% në fashën mbi 120,000 lekë.

Figura 10: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2025




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** (N=44)

Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara (shiko figurën 11), pasqyron një përmirësim të nivelit të pagave të të diplomuarve krahasuar me mesataren e viteve 2016 - 2024. Përqindja e të rinjve që marrin një pagë më të ulët se paga minimale ka rënë me 11 pikë përqindje. Edhe pjesa e të diplomuarve që paguhen me pagën minimale deri në 35,000 lekë ka rënë ndjeshëm, me 31 pikë përqindje më pak se mesatarja ndër vite (0% në 2025 kundrejt 31% mesatarja 2016 - 2024).

Kategoria e pagave 35,001 - 50,000 lekë mbetet relativisht e qëndrueshme, me një ulje prej rreth 12 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve të mëparshme (20% në 2024 kundrejt 32% mesatarja 2016 - 2024).

Rritja më e dukshme vërehet te pagat e mesme dhe të larta. Numri i të diplomuarve që marrin 50,00 - 65,000 lekë është rritur me rreth 14 pikë përqindje mbi mesataren ndër vite (23% në 2025 kundrejt 9% mesatarja 2016 - 2024). Po ashtu, pjesa e atyre që fitojnë 65,001- 80,000 lekë është rritur me 12 pikë përqindje (21% në 2025 kundrejt vetëm 9% mesatarja e mëparshme). Një rritje e konsiderueshme shfaqet edhe te të diplomuarit me pagë mbi 80,001 lekë, ku 2025 shënon një rritje prej 27 pikë përqindje mbi mesataren ndër vite (36% në 2025 kundrejt 9% mesatarja 2016 - 2024).


Figura 11: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=9); **2017 (**N=43); **2018 (**N=36) **2019** (N=38); **2020** (N=74), **2021** (N=92); **2022** (N=81); **2023** (N=60), **2024** (N=58), **2025** (N=44)

Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve (shiko figurën 12), vëmë re se 50% e të diplomuarve në Termohidraulikë, 43% e të diplomuarve në Elektroteknikë, 35% e të diplomuarve në TIK dhe 25% e të diplomuarve në secilin prej drejtimeve Mekanikë dhe SHMT marrin mbi 80,000 lekë. Ndërkohë, 30% e të diplomuarve në TIK, 25% e të diplomuarve në Mekanikë dhe 13% e të diplomuarve në SHMT marrin 60,001–80,000 lekë.

Figura 12: Niveli i pagave sipas drejtimit (2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N_{EL}=7, N_{TH}=2, N_{M}=4, N_{SHMT}=8, N_{TIK}=23

Kushtet e punës

Të pyetur lidhur me karakteristikat kryesore të punës (me kohë të plotë apo të pjesshme), për të dhjetë brezat e gjurmuar vërehet se mbizotëron punësimi me kohë të plotë. Në vitin 2025, 82% e të diplomuarve punojnë me kohë të plotë, përqindje kjo e pandryshuar krahasuar me vitin 2024. Ndërkohë, 11% punojnë me kohë të pjesshme, me një rritje prej 1 pike përqindjeje krahasuar me vitin 2024 (10%). Punësimi me kohë të plotë sezonale ka shënuar një ulje prej 1 pike përqindjeje, nga 8% në vitin 2024 në 7% në vitin 2025.


Figura 13: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt punësimit me kohë të pjesshme (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=8); **2017 (**N=32); **2018 (**N=32) **2019** (N=24); **2020** (N=63), **2021** (N=85); **2022** (N=73); **2023** (N=49), **2024** (N=48), **2025** (N=44)

Për sa i përket shpërndarjes së të diplomuarve sipas tipologjisë së kompanisë (shiko figurën 14), në brezin e fundit të të gjurmuarve vërehet se 43% e të diplomuarve punojnë në kompani me 1-4 punonjës, 18% në kompani me 10-49 punonjës, 16% në kompani me 5-9 punonjës dhe 23% në kompani me më shumë se 50 punonjës. Mesatarisht, 2016-2024, 39% e të diplomuarve punojnë në kompani me 1-4 punonjës, 29% në kompani me 5-9 punonjës, 22% në kompani me 10-49 punonjës dhe 10% në kompani me mbi 50 punonjës.


Figura 14: Madhësia e kompanisë (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=8); **2017 (**N=32); **2018 (**N=32) **2019** (N=24); **2020** (N=63), **2021** (N=85); **2022** (N=73); **2023** (N=49), **2024** (N=48), **2025** (N=44)

Në vitin 2025, 64% e të diplomuarve kanë një kontratë pune me punëdhënësin e tyre (shiko figurën 15). Prej tyre, 32% kanë një kontratë pune me afat të caktuar dhe 32% me afat të pacaktuar. Ndërkohë, 34% nuk kanë një kontratë pune, ndërsa 2% janë duke kryer praktikë. Përqindja e të diplomuarve pa kontratë mbetet e lartë, rreth 4 pikë përqindjeje mbi mesataren e viteve 2016–2024 (30%), megjithëse ka shënuar një ulje prej 1 pike përqindjeje krahasuar me vitin 2024 (35%).


Figura 15: Lloji i kontratës (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=8); **2017 (**N=32); **2018 (**N=32) **2019** (N=24); **2020** (N=63), **2021** (N=85); **2022** (N=73); **2023** (N=49), **2024** (N=48), **2025** (N=44)

Sipas rezultateve të gjurmimit për vitin 2025, 84% e të diplomuarve të punësuar deklarojnë se u paguhen kontributet e detyrueshme nga ana e punëdhënësit (shiko figurën 16). Ndërkohë, 14% e të punësuarve pohojnë se nuk u paguhen kontributet e detyrueshme dhe 2% nuk kanë dijeni.

Figura 16: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=8); **2017 (**N=32); **2018 (**N=32) **2019** (N=24); **2020** (N=63), **2021** (N=85); **2022** (N=73); **2023** (N=49), **2024** (N=48), **2025** (N=44)

Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqësia në vendin e punës

Të pyetur se sa të sigurt dhe të stabilizuar ndjeheshin në vendin e tyre të punës, 73% e të diplomuarve në vitin 2025 u shprehën se ndjehen "të sigurt ose shumë të sigurt" (shiko tabelën 5). Mesatarisht, gjatë viteve 2016–2024, rreth 65% e të diplomuarve u shprehën se ndjehen "të sigurt ose shumë të sigurt", duke shënuar për vitin 2025 një rritje prej rreth 8 pikësh përqindjeje. Ndërkohë, 9% e të diplomuarve janë shprehur "shumë të pasigurt". Mesatarisht, gjatë viteve 2016–2024, rreth 6% e të diplomuarve ndjeheshin "shumë të pasigurt", duke shënuar për vitin 2025 një rritje prej rreth 3 pikësh përqindjeje.

Ndërkohë, të pyetur lidhur me kënaqësinë në vendin e punës, 73% e të diplomuarve në vitin 2025 shprehen se ndjehen "të kënaqur ose shumë të kënaqur" dhe 5% shprehen "shumë të pakënaqur". Sikurse tregon edhe tabela 5, për vitin 2025 vërehen nivele të njëjta të sigurisë dhe kënaqësisë së raportuar në vendin e punës.

Tabela 5: Perceptimet për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2016-2025)


	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Shumë i/e pasigurt	0%	0%	3%	8%	0%	4%	8%	12%	13%	**9%**
I/e pasigurt	25%	22%	13%	17%	25%	8%	7%	6%	6%	**0%**
Neutral	0%	19%	28%	4%	37%	19%	16%	22%	23%	**18%**
I/e sigurt	38%	28%	41%	46%	35%	54%	34%	22%	21%	**30%**
Shumë i/e sigurt	38%	31%	16%	25%	3%	15%	34%	37%	38%	**43%**
Shumë i/e pakënaqur	0%	6%	0%	8%	2%	1%	3%	8%	8%	**5%**
I/e pakënaqur	13%	19%	13%	8%	13%	12%	3%	6%	6%	**2%**
Neutral	0%	19%	25%	4%	30%	21%	22%	16%	17%	**21%**
I/e kënaqur	38%	25%	50%	54%	51%	52%	38%	35%	33%	**39%**
Shumë i/e kënaqur	50%	31%	13%	25%	5%	14%	34%	35%	35%	**34%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=8); **2017 (**N=32); **2018 (**N=32) **2019** (N=24); **2020** (N=63), **2021** (N=85); **2022** (N=73); **2023** (N=49), **2024** (N=32), **2025** (N=44)

Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për kohën që u është dashur për të filluar punën e tyre të parë, 66% e të diplomuarve në vitin 2025 u përgjigjën se e kanë gjetur punën para diplomimit, 11% e kanë gjetur punën 1 muaj pas diplomimit, 16% e kanë gjetur punën 1–3 muaj pas diplomimit, 2% e kanë gjetur punën 3–6 muaj pas diplomimit dhe 5% e kanë gjetur punën 6–9 muaj pas diplomimit.

Figura 17: Periudha kohore në kërkim të një pune (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** (N=44)

Ndërkohë, mesatarisht gjatë viteve 2016–2024, rreth 64% e të diplomuarve e kanë gjetur punën para diplomimit. Në këtë aspekt, për vitin 2025, kur kjo përqindje arrin në 66%, vërehet një rritje prej rreth 2 pikësh përqindjeje. Ndërkohë, për të nëntin vit radhazi, asnjë i diplomuar nuk raporton se e ka gjetur punën më shumë se një vit pas diplomimit.

Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2016-2025)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	**2023**	**2024**	**2025**
Para diplomimit	50%	66%	70%	72%	44%	52%	70%	74%	73%	**66%**
1 muaj pas diplomimit	10%	8%	10%	7%	6%	17%	10%	4%	4%	**11%**
1 - 3 muaj pas diplomimit	20%	8%	10%	3%	26%	12%	9%	10%	10%	**16%**
3 - 6 muaj pas diplomimit	0%	5%	5%	14%	16%	7%	4%	2%	2%	**2%**
6 - 9 muaj pas diplomimit	0%	11%	3%	3%	7%	7%	3%	6%	6%	**4%**
9 - 12 muaj pas diplomimit	10%	3%	3%	0%	1%	5%	4%	4%	4%	**0%**
Më shumë se 1 vit pas diplomimit	10%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	0%	**0%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=8); **2017 (**N=32); **2018 (**N=32) **2019** (N=24); **2020** (N=63), **2021** (N=85); **2022** (N=73); **2023** (N=49), **2024** (N=48), **2025** (N=44)

Mënyrat e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për mënyrën e gjetjes së punës së parë, vërehet se për të dhjetë brezat e gjurmuar njohjet, lidhjet familjare dhe miqtë janë forma më e zakonshme nëpërmjet së cilës të diplomuarit kanë gjetur punë për herë të parë, me një mesatare prej rreth 64%. Në vitin 2025, kjo përqindje është 55%, duke shënuar një ulje prej 12 pikësh përqindjeje krahasuar me vitin 2024 (67%).

Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2016-2025)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	**2022**	**2023**	**2024**	**2025**
Nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë	0%	6%	0%	0%	13%	19%	14%	10%	10%	**23%**
Nga njohjet, lidhjet familjare, miqtë	75%	59%	75%	67%	73%	39%	67%	65%	67%	**55%**
Nga praktika profesionale në biznes	13%	0%	13%	21%	10%	15%	7%	8%	8%	**7%**
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim	13%	16%	3%	8%	2%	12%	7%	4%	4%	**5%**
Nga mësuesit	0%	0%	3%	0%	3%	8%	3%	2%	2%	**0%**
Nga Zyra e Punësimit	0%	6%	3%	0%	0%	1%	0%	0%	0%	**5%**
Nga qendra e karrierës/njësia e zhvillimit në shkollë	0%	9%	0%	0%	0%	6%	1%	0%	0%	**7%**
Tjetër	0%	3%	3%	4%	0%	0%	1%	10%	8%	**0%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=8); **2017 (**N=32); **2018 (**N=32) **2019** (N=24); **2020** (N=63), **2021** (N=85); **2022** (N=73); **2023** (N=49), **2024** (N=48), **2025** (N=44)

Lidhur me mënyrat e mbështetjes së shkollës në kapërcimin e fazës tranzitore drejt tregut të punës (shiko tabelën 8), në vitin 2025, 27% pohuan se shkolla i ka mësuar si të kërkojnë dhe të aplikojnë për punë, me një ulje prej rreth 1 pike përqindjeje krahasuar me mesataren e viteve 2016–2024 (28%). Ndërkohë, 30% pohuan se shkolla i ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit, me një ulje prej 4 pikësh përqindjeje krahasuar me mesataren e viteve 2016–2024 (34%). Gjithashtu, 32% pohuan se përgjithësisht shkolla nuk i ka ndihmuar, me një rritje prej rreth 3 pikësh përqindjeje krahasuar me mesataren e viteve 2016–2024 (29%).

Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2016-2025)

	2016	**2017**	**2018**	**2019**	**2020**	**2021**	**2022**	**2023**	**2024**	**2025**
Kam mësuar si të kërkoj dhe të aplikoj për punë	0%	12%	6%	18%	70%	43%	25%	31%	31%	**27%**
Më ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit	44%	30%	22%	32%	50%	43%	28%	29%	28%	**30%**
Më ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë	44%	16%	17%	18%	24%	24%	12%	14%	14%	**9%**


Përgjithësisht nuk më ka ndihmuar	11%	37%	50%	32%	9%	13%	35%	25%	26%	**32%**
Tjetër	0%	5%	6%	8%	1%	2%	7%	10%	10%	**7%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=9); **2017 (**N=43); **2018 (**N=36) **2019** (N=38); **2020** (N=74), **2021** (N=92); **2022** (N=81); **2023** (N=59), **2024** (N=58), **2025** (N=56)

Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme

Për vitin 2025, 11% e të diplomuarve janë studentë/kursantë dhe 11% janë të punësuar, por edhe studiojnë në të njëjtën kohë. Mesatarisht, gjatë viteve 2016–2024, rreth 11% e të diplomuarve kanë qenë studentë/kursantë dhe rreth 7% kanë qenë të punësuar, por edhe kanë studiuar në të njëjtën kohë.


Figura 18: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=20); **2017 (**N=58); **2018 (**N=61) **2019** (N=55); **2020** (N=103), **2021** (N=121); **2022** (N=101); **2023** (N=79), **2024** (N=77), **2025** (N=73)

Sikurse në vitet paraardhëse, pjesa më e madhe e të diplomuarve në 2025 që ndjekin kualifikime të mëtejshme kanë zgjedhur universitetin 88% dhe vetëm 13% studiojnë pranë një shkolle profesionale pas të mesmes.


Figura 19: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2016** (N=3); **2017 (**N=5); **2018 (**N=7) **2019** (N=15); **2020** (N=18), **2021** (N=28); **2022** (N=23); **2023** (N=8), **2024** (N=12), **2025** (N=8)

Nga të diplomuarit që ndjekin studime të mëtejshme,63% studiojnë në institucione publike dhe 38% në ato private. Mesatarisht, gjatë viteve 2020-2025 84% e të diplomuarve kanë studiuar në institucione publike dhe 16% në institucione private.

Figura 20: Lloji i institucionit (2020-2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2020** (N=18), **2021** (N=28); **2022** (N=23); **2023** (N=8), **2024** (N=12), **2025** (N=8)

Ndërkohë, të pyetur nëse studimet/trajnimet që po ndjekin lidhen me shkollën që kanë bërë (shiko figurën 21), 88% e të gjurmuarve që studiojnë në vitin 2025 janë shprehur se fusha e studimeve që

po ndjekin aktualisht lidhet me shkollën që kanë bërë, përkundrejt 13% të cilët shprehen se studimet e mëtejshme nuk lidhen me të. Gjatë viteve 2020–2024, mesatarisht rreth 75% e të gjurmuarve u shprehën se studimet/trajnimet që ndjekin lidhen me shkollën që kanë bërë, përkundrejt rreth 25% të cilët pohuan se nuk lidhen.

Figura 21: Lidhja e studimeve me profesionin (2020-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2020** (N=18), **2021** (N=28); **2022** (N=23); **2023** (N=8), **2024** (N=12), **2025** (N=8)

Të pyetur mbi arsyet e ndjekjes së studimeve të mëtejshme (shiko tabelën 9), 78% e të diplomuarve në vitin 2025 janë përgjigjur se i ndjekin për të fituar një kualifikim më të lartë (rreth 37% mesatarja e viteve 2016–2024), ndërsa 22% për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë (rreth 48% mesatarja e viteve 2016–2024).

Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2016-2025)


	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	
Për të fituar një kualifikim më të lartë	0%	60%	29%	11%	44%	32%	48%	50%	62%	78%
Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë	67%	40%	57%	56%	39%	50%	35%	50%	39%	22%
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale	33%	0%	14%	33%	17%	18%	9%	0%	0%	

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2016** (N=3); **2017** (N=5); **2018** (N=7); **2019** (N=15); **2020** (N=18); **2021** (N=28); **2022** (N=23); **2023** (N=8), **2024** (N=12), **2025** (N=8)

Të diplomuarit pa punë

Për vitin 2025, 12% e të diplomuarve të gjurmuar ishin të papunë një vit pas diplomimit, me një ulje prej 7 pikësh përqindje nga mesatarja 2016-2024 (19%).


Figura 22: Papunësia ndër vite (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2016** (N=20), **Baza**: **2017** (N=58), **2018** (N=61); **2019** (N=55); **Baza**: **2020** (N=103); **2021** (N=121); **2022** (N=101); **2023** (N=79), **2024** (N=77), **2025** (N=73)

Të pyetur nëse po kërkonin punë, 78% e të diplomuarve të papunë të vitit 2025 u përgjigjën që po. Ndërsa 22% e të diplomuarve të papunë nuk janë në kërkim të një pune.

Figura 23: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2020** (N=19); **2021** (N=13); **2022** (N=11); **2023** (N=11), **2024** (N=11), **2025** (N=9)

Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara (shiko tabelën 10) nxjerr në pah se arsyet kryesore që të diplomuarit raportojnë për pamundësinë për të gjetur një punë në vitin 2025 janë: (i) mospërputhja e ofertave për punë me arsimimin e tyre, 50% (N=1), me një rritje prej rreth 37 pikësh përqindjeje krahasuar me mesataren e viteve 2016–2024 (13%); dhe (ii) mungesa e njohjeve apo kontakteve të duhura për të gjetur një punë, 50% (N=1), me një rritje prej rreth 29 pikësh përqindjeje krahasuar me mesataren e viteve 2016–2024 (21%). Ndërkohë, mungesa e eksperiencës së punës dhe mungesa e punës në qark nuk janë raportuar si pengesa në vitin 2025.

Tabela 10: Arsyet kryesore të papunësisë (2016-2025)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Më mungon eksperienca e punës	0%	6%	12%	17%	12%	17%	13%	22%	22%	**0%**
Njohuritë që kam marrë nga shkolla nuk përputhen me tregun e punës	0%	6%	0%	0%	6%	17%	0%	0%	0%	**0%**
Ofertat për punë nuk lidhen me arsimimin tim	0%	19%	24%	0%	18%	17%	13%	11%	11%	**50%**
Nuk kam njohjet/kontaktet e duhura për të gjetur një punë	67%	6%	0%	0%	35%	33%	0%	22%	22%	**50%**
Nuk ka punë në qarkun tim	17%	25%	18%	25%	29%	17%	38%	22%	22%	**0%**
Jam i/e angazhuar në punë familjare	0%	6%	6%	0%	0%	0%	0%	11%	11%	**0%**
Nuk di si të kërkoj për punë	0%	0%	0%	0%	0%	0%	25%	11%	11%	**0%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2016** (N=6), **Baza**: **2017** (N=16), **2018** (N=17); **2019** (N=12); **Baza**: **2020** (N=17); **2021** (N=6); **2022** (N=8); **2023** (N=9), **2024** (N=9), **2025** (N=_2)

Të pyetur për arsyet e mos kërkimit të punës (shiko tabelën 11), 50% e të diplomuarve të papunë të gjurmuar në vitin 2025 u përgjigjën se nuk kanë dëshirë të punojnë për momentin, ndërsa 50% pohuan se kanë në plan të largohen nga vendi. Ndryshe nga viti 2024, kur askush nuk kishte raportuar plane për t'u larguar nga vendi, në vitin 2025 kjo është një nga dy arsyet kryesore të mos kërkimit të punës. Asnjë prej të anketuarve nuk është shprehur se po pret të fillojë punë së shpejti apo se nuk ka besim se do të gjejë një punë.


Tabela 11: Arsyet kryesore të mos kërkimit për punë (2020-2025)

	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Po pres të filloj punë së shpejti	0%	14%	33%	0%	0%	**0%**
Nuk kam besim se do gjej një punë	0%	14%	0%	50%	50%	**0%**
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	0%	29%	67%	50%	50%	**50%**
Kam në plan të largohem nga vendi	50%	43%	0%	0%	0%	**50%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2020** (N=2); **2021** (N=7); **2022** (N=3); **2023** (N=2), **2024** (N=2), **2025** (N=2)

Sikurse e tregon edhe figura 24, vetëm 33% e të diplomuarve të papunë në vitin 2025 kanë qenë më herët në marrëdhënie pune, me një rënie prej 15 pikësh përqindje nga mesatarja 2016-2024 (48%).

Figura 24: Niveli i të diplomuarve të papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2016-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2016** (N=6); **2017** (N=16); **2018** (N=17); **2019** (N=12); **2020** (N=19); **2021** (N=13); **2022** (N=11); **2023** (N=11), **2024** (N=11), **2025** (N=9)

Propozimet për përmirësim në shkollë

Të pyetur se cilat aspekte të shkollës kanë nevojë për përmirësim me qëllim përgatitjen më të mirë të nxënësve për tregun e punës, të gjurmuarit në vitin 2025 evidentuan nevojën për "shumë/ jashtëzakonisht shumë" përmirësim në të gjitha aspektet e paraqitura në tabelën 12. Theksi këtë vit është te: (i) këshillimi i karrierës, 67%, me një rritje prej 16 pikësh përqindjeje krahasuar me mesataren e viteve 2016–2024 (51%); (ii) praktika në shkollë, 64%, me një rritje prej rreth 13 pikësh përqindjeje krahasuar me mesataren e viteve 2016–2024 (51%); (iii) aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve, 63%, me një rritje prej 17 pikësh përqindjeje krahasuar me mesataren e viteve 2018–2024, për të cilat ka të dhëna (46%); (iv) bashkëpunimi me bizneset, 63%, me një rritje prej rreth 9 pikësh përqindjeje krahasuar me mesataren e viteve 2016–2024 (54%); dhe (v) praktika në biznes, 61%, me një rritje prej rreth 7 pikësh përqindjeje krahasuar me mesataren e viteve 2016–2024 (54%).

Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkollë "shumë/jashtëzakonisht shumë" (2016-2025)


	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Infrastruktura	78%	9%	25%	29%	39%	60%	41%	49%	43%	**57%**
Kurrikula			17%	26%	50%	69%	43%	51%	51%	**55%**
Tekstet dhe materialet	67%	19%	22%	39%	59%	66%	42%	58%	59%	**58%**

Metodat e mësimdhënies	56%	16%	25%	29%	50%	64%	47%	52%	52%	**55%**
Aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve			14%	34%	50%	62%	48%	57%	57%	**63%**
Praktika në shkollë	67%	33%	44%	39%	54%	65%	48%	54%	54%	**64%**
Praktika në biznes	67%	35%	42%	45%	67%	72%	49%	55%	55%	**61%**
Këshillimi i karrierës	56%	30%	39%	42%	79%	67%	44%	51%	51%	**67%**
Bashkëpunimi me bizneset	33%	42%	50%	84%	65%	49%	54%	33%	55%	**63%**
Bashkëpunimi me zyrat e punësimit	44%	42%	25%	47%	82%	68%	46%	54%	54%	**58%**

Shënim: Kjo është pyetje ku janë marrë të dhënat e të diplomuarve që janë përgjigjur "shumë/jashtëzakonisht shumë". Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza**: **2016** (N=9); **2017** (N=43), **2018** (N=36); **2019** (N=38); **2020** (N=103); **2021** (N=112); **2022** (N=101); **2023** (N=69),); **2024** (N=67), **2025** (N=23)

Nëse do të kishin mundësi, 88% e të diplomuarve në vitin 2025 do të zgjidhnin të njëjtin drejtim profesional dhe 81% të njëjtën shkollë (shiko figurën 25). Mesatarisht, gjatë viteve 2018–2025, rreth 83% e të diplomuarve do të përzgjidhnin të njëjtën degë dhe rreth 80% të njëjtën shkollë.

Figura 25: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2016-2025)



Shënim: Kjo është pyetje ku janë marrë të dhënat e të diplomuarve që janë përgjigjur "shumë/jashtëzakonisht shumë". Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza**: **2016** (N=9); **2017** (N=43), **2018** (N=36); **2019** (N=38); **2020** (N=103); **2021** (N=112); **2022** (N=101); **2023** (N=69), **2024** (N=77), **2025** (N=73)

Të disagreguara sipas drejtimeve, të dhënat për përzgjedhjen e të njëjtës degë dhe shkollë paraqiten në tabelën 13. Për vitin 2025, vëmë re se të diplomuarit në Termohidraulikë kanë nivelin më të lartë të përzgjedhjes së të njëjtës degë (100%), ndërsa 80% do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë. Në Elektroteknikë, 92% do të përzgjidhnin të njëjtën degë dhe 77% të njëjtën shkollë. Të diplomuarit në TIK do të përzgjidhnin të njëjtën degë në masën 88% dhe të njëjtën shkollë në masën 82%. Ndërkohë, në SHMT, 85% do të përzgjidhnin si të njëjtën degë, ashtu edhe të njëjtën shkollë, duke shënuar

nivelin më të lartë të përzgjedhjes së shkollës. Në Mekanikë, 78% do të përzgjidhnin si të njëjtën degë, ashtu edhe të njëjtën shkollë. Niveli më i ulët i përzgjedhjes së të njëjtës degë vërehet në Mekanikë (78%), ndërsa ai i përzgjedhjes së të njëjtës shkollë në Elektroteknikë (77%).

Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2018-2025)

		Elektroteknikë	Termohidraulikë	Mekanikë	SHMT	TIK
2018	Degë	67%	100%	67%	74%	88%
	Shkollë	60%	75%	73%	79%	63%
2019	Degë	100%	67%	85%	85%	91%
	Shkollë	100%	89%	92%	92%	100%
2020	Degë	100%	100%	94%	97%	97%
	Shkollë	100%	86%	89%	93%	93%
2021	Degë	88%	100%	91%	93%	91%
	Shkollë	76%	88%	91%	86%	91%
2022	Degë	94%	62%	81%	67%	81%
	Shkollë	76%	54%	62%	56%	78%
2023	Degë	80%	46%	65%	81%	87%
	Shkollë	75%	55%	65%	88%	87%
2024	Degë	80%	73%	67%	83%	72%
	Shkollë	80%	64%	73%	83%	69%
2025	**Degë**	**92%**	**100%**	**78%**	**85%**	**88%**
	Shkollë	**77%**	**80%**	**78%**	**85%**	**82%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2018**: N_{TIK}=8, N_{SHMT}=19, N_{M}=15, N_{TH}=4, N_{EL}=15; **Baza 2019**: N_{TIK}=11, N_{SHMT}=13, N_{M}=13, N_{TH}=9, N_{EL}=9; **Baza 2020**: N_{TIK}=29, N_{SHMT}=30, N_{M}=18, N_{TH}=14, N_{EL}=12; **Baza 2021**: N_{TIK} =33, N_{SHMT} =29, N_{M} =34, N_{TH} =8, N_{EL} =17; **Baza 2022:** N_{TIK}=37, N_{SHMT}=18, N_{M}=16, N_{TH}=13, N_{EL}=17; **Baza 2023:** N_{TIK}=15, N_{SHMT}=16, N_{M}=17, N_{TH}=11, N_{EL}=20, **Baza 2024:** N_{TIK}=29, N_{SHMT}=12, N_{M}=17, N_{TH}=11, N_{EL}=10, **Baza 2025:** N_{TIK}=33, N_{SHMT}=13, N_{M}=9, N_{TH}=5, N_{EL}=13

Planet për të ardhmen

Të pyetur për planet që kanë për të ardhmen e tyre të afërt në aspektin profesional dhe të kualifikimit të mëtejshëm (shiko tabelën 14), 52% e të diplomuarve në vitin 2025 kanë pohuar se kanë dëshirë të kenë filluar biznesin e tyre. Aspiratat për sipërmarrje kanë shënuar nivelin më të lartë ndër vite, ndërsa mesatarja e viteve 2016–2024 ka qenë rreth 30%. Ndërkohë, 25% e të diplomuarve duan të jenë të punësuar, me një rritje prej rreth 4 pikësh përqindjeje krahasuar me mesataren e viteve 2016–2024 (21%), ndërsa 27% kanë dëshirë të kenë gjetur një punë që lidhet me fushën e tyre të studimit, pothuajse në të njëjtin nivel me mesataren e viteve 2016–2024 (27%).

Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2016-2025)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	
Të jem punësuar	44%	9%	13%	13%	23%	14%	21%	27%	27%	**25%**

Të kem gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit	6%	17%	31%	33%	41%	36%	26%	25%	24%	**27%**
Të kem filluar biznesin tim	11%	19%	26%	20%	23%	32%	45%	48%	48%	**52%**
Të kem ndjekur studime të mëtejshme	17%	28%	33%	13%	34%	16%	13%	19%	18%	**19%**
Të kem emigruar jashtë vendit	6%	28%	25%	35%	36%	19%	19%	10%	10%	**10%**
Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	28%	0%	2%	0%	2%	1%	2%	3%	3%	**1%**
Tjetër	28%	10%	15%	15%	1%	1%	1%	4%	4%	**3%**

Shënim: Kjo është pyetje ku janë marrë të dhënat e të diplomuarve që janë përgjigjur "shumë/jashtëzakonisht shumë". Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza**: **2016** (N=9); **2017** (N=43), **2018** (N=36); **2019** (N=38); **2020** (N=103); **2021** (N=112); **2022** (N=101); **2023** (N=69), **2024** (N=77), **2025** (N=73)

Rekomandime për forcimin institucional

Rekomandimet e mëposhtme lidhen drejtpërdrejt me gjetjet e raportit të gjurmimit për Shkollën Industriale "Pavarësia". Për brezin 2025 janë gjurmuar 73 nga 85 të diplomuarit. Rezultatet për profilet dhe nëngrupet me pak përgjigje duhen diskutuar me të diplomuarit përpara përgjithësimit.

1. Më shumë mundësi për punësim në profesion

Njësia e Zhvillimit të diskutojë me të diplomuarit që punojnë jashtë fushës së studimit për pengesat dhe preferencat e tyre. Me bizneset partnere të identifikohen mundësi punësimi të lidhura me profilet dhe nevoja për aftësi plotësuese.

Gjetja: Vetëm 35% raportojnë se puna aktuale lidhet me arsimin, niveli më i ulët i raportuar ndër vite. Ndër arsyet e punësimit jashtë profesionit, 37% përmendin pamundësinë për të gjetur punë në fushën e studimit, 27% preferencën për të punuar jashtë saj dhe 17% pagën ose kushtet më të mira.

2. Orientim në karrierë me mbështetje konkrete për gjetjen e punës

Shkolla të ofrojë ushtrime për aplikimin dhe intervistën, takime me punëdhënës dhe referime te zyra e punësimit. Të ndiqen individualisht të diplomuarit pa punë dhe rezultatet e ndërmjetësimit.

Gjetja: Vetëm 27% raportojnë se shkolla i ka mësuar të kërkojnë dhe të aplikojnë për punë, ndërsa 9% se i ka ndihmuar të vendosin kontakte me punëdhënës. Përgjithësisht pa ndihmë nga shkolla ndihen 32%. Nga 9 të diplomuarit pa punë, 7 kërkojnë punë.

3. Praktikë më cilësore dhe aftësi më të zbatueshme

Ekipet lëndore të rishikojnë detyrat praktike me kontributin e bizneseve dhe të diplomuarve. Aktivitetet e ZHVP-së të fokusohen te aftësitë profesionale dhe metodat që ndihmojnë nxënësit t'i zbatojnë njohuritë në situata pune.

Gjetja: Raporti paraqet nevojë për përmirësimin e praktikës në shkollë nga 64%, të aftësive teorike dhe praktike të mësuesve nga 63% dhe të praktikës në biznes nga 61%. Gjithashtu, 23% deklarojnë se nuk i përdorin aspak njohuritë e fituara në shkollë në punën aktuale. Baza e treguesve për përmirësim duhet verifikuar.

4. Më shumë informacion për kontratat dhe kushtet e punës

Orientimi në karrierë të përfshijë sesione praktike për kontratat, kushtet e punës dhe verifikimin e sigurimeve. Në kontaktet pas diplomimit të identifikohen të diplomuarit që kanë nevojë për sqarim ose orientim drejt shërbimeve përkatëse.

Gjetja: Në 2025, 34% e të diplomuarve të pyetur raportojnë se punojnë pa kontratë, kundrejt 35% në 2024. Megjithëse ka një përmirësim të lehtë, punësimi pa kontratë mbetet i përhapur.

5. Mbështetje praktike për planet e sipërmarrjes

Të diplomuarve që synojnë hapjen e një biznesi t'u ofrohet këshillim për zhvillimin e idesë, vlerësimin e tregut dhe planifikimin financiar. Të krijohen kontakte me sipërmarrës dhe shërbime mbështetëse sipas profilit.

Gjetja: Në 2025, 52% dëshirojnë të kenë filluar biznesin e tyre brenda dy viteve, ndërsa 17% janë aktualisht të vetëpunësuar. Ky interes kërkon sqarimin e gatishmërisë dhe të mbështetjes së nevojshme për konkretizimin e planeve.